



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 32 Prot

Tiranë më 09. 01. 2015

V E N D I M

Nr. 1 Datë 09/ 01/2015

“Për kryerjen e inspektimit në lidhje me proceset e konfirmimit/refuzimit të deklaramit të statusit të nëpunësit civil, për punonjësit e institucionit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar”

Gjatë hetimit administrativ të disa rasteve të refuzimit/konfirmimit të deklaramit të statusit të nëpunësit civil, për disa prej punonjësve të institucionit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, ka lindur dyshim i arsyeshëm se gjatë kryerjes së procesit të konfirmimit apo refuzimit të statusit, në zbatim të detyrimit që parashikon neni 67 i ligjit nr. 152/2013, janë lejuar parregullsi apo pasaktësi të cilat mund të kenë ndikuar në konkluzionet apo vendimarrjen e organeve kompetente,

Për këtë arsye

me propozim të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, bazuar në nenin 11, pika 1 dhe nenin 14, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” me qëllim verifikimin e gjithë rasteve të konfirmimit apo refuzimit të statusit të nëpunësve civilë në institucionin në fjalë,

VENDOSA:

1. Fillimin e inspektimit të përgjithëshëm të procesit të konfirmimit apo refuzimit të statusit të nëpunësit civil, të punonjësve të institucionit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.
2. Ngritjen e grupit të inspektimit, me këtë përbërje:

- **Altin Shumeli** - Përgjegjës grupi
- **Behare Hoxha** - anëtare
- **Aida Dobjani** - anëtare
- **Sajmir Muçmata** - anëtar

3. Inspektimi të përfshijë verifikimin e gjithë praktikës së konfirmimit apo refuzimit të statusit të nëpunësit civil, të punonjësve të institucionit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar. Për këtë të merret fillimisht, një kopje në version elektronik i materialit që është dërguar prej institucionit në Departamentin e Administratës Publike.
4. Ky inspektim të kryhet prej datës 12.01.2015 deri në dt. 27.01.2015.
5. Relacioni të përgatitet nga Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ dhe t'i paraqitet Komisionerit për miratim.
6. Të merren masat për njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet inspektimit në përputhje me nenin 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA